

AKT THEME LIMI DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“OG TRANS GROUP” SH.P.K

Sot me date 02/08/2023 :

- Miranda Nela, atesia Theofan , shtetas Shqipetar lindur me 21/08/1982 ne ,Vlore, banuese ne Tirane, me dokument identifikimi me I25821116D;

bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht, bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare» i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 , Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 ”Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, LIGJ Nr. 131/2015 PER QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT, ne dispozitat e Kodit Civil ne cilesine e ortakeve themelues si dhe ne vullnetin tone te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e akteve te themelimit te shoqerise kemi hartuar aktin e themelimit dhe statutin e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte shoqeria):

KREU I
THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA
NENI. 1
DATA E THEMELIMIT, EMRI I THEMELUESIT

Sot ne date 02/08/2023,u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin

“OG TRANS GROUP” SH.P.K

1. Themeluesit e shoqerise jane :

Miranda Nela, atesia Theofan , shtetas Shqipetar lindur me 21/08/1982 ne ,Vlore, banuese ne Tirane, me dokument identifikimi me I25821116D;

NENI. 2
OBJEKTI I SHOQERISE

Objekt i kesaj shoqerie do te jete:

Transport brenda vendit dhe nderkombetar i mallrave.Qiradhenia e automjeteve te te gjitha llojeve.
Import-eksport te gjitha produkteve me karaktere tregtar.
Cdo aktivitet tjeter te lidhur me aktivitetin kryesor.

Per te gjitha aktivitetet qe kerkojne licenca te vecanta shoqeria do te angazhohet qe tani per te plotesuar kerkesat e ligjeve te posacme.

NENI. 3
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise do te jete deri ne nje afat te papercaktuar
Shoqeria mund te priset perpara ketij afati me vendim te asamblese se Ortakeve.

NENI. 4
SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise .eshte ne adresen: Bulevardi Deshmoret e Kombit, Qendra e Biznesit
"Kullat Binjake" kati 2, nr. 26 Tirane.

KREU II
KAPITALI

NENI. 5
KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoqerise do te jete 100.000(njeqind mije) leke i perbere nga nje kuote.

Pjesemarrja e ortakut themelues ne kapitalin e shoqerise eshte:

Kontributi ne kapitalin e shoqerise eshte 100.000 leke dhe perbehet nga 1 (nje) kuote me vlere
nominale 100.000 leke nga Ortaku :

- Miranda Nela, atesia Theofan , shtetas Shqipetar lindur me 21/08/1982 ne ,Vlore, banuese
ne Tirane, me dokument identifikimi me I25821116D; zoteron 100% te kuotes me vlere
100.000 leke.

Kontributet e ortakëve mund te jene ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme, apo
te drejta).

NENI. 6
ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te
regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te
kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar
per keto kontribute.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e
regjistruar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe
kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

NENI. 7
TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.

Pjeset e kapitalit te regjistruar jane te transferueshme me rruge trashegimije, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III
ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE
NENI. 8
ORGANET VENDIMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimares i shoqerise.

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a. Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b. Ndryshimet e statutit
- c. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d. Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e. Percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f. Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g. Miratimi,i bilanceve
- h. Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- i. Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre
- j. Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k. Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- l. Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m. Ceshjte te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9
THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites



e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullslse.

NENI 10 KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumi i permendur ne paragrafin e mesiperm nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11 MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e pergjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizmin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera.

Cdo ndryshim duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12 PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin pet:

- a) vleresmin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konfikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 13
ADMINISTRIMI

Asambleja e pergjithshme emerohet nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte ripertitje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise, duke patur te drejta te pakufizuara administrimi:

- Miranda Nela, atesia Theofan, shtetas Shqiptar, lindur me 21/08/1982 ne Vlore, banuese ne Tirane, me dokument identifikimi me I25821116D;

NENI 14
KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregetare
- b) Perfaqesojne shoqerine
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- d) Pergatish dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercejne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- g) Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise
- h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregulloret e tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte.

NENI 15
PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Administratoret te cilet kane kryer veprime ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane pergjegjes per demet e sjella shoqerise dhe pergjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.



2. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale është i detyruar të demshperblejë shoqërisë dëm që rrjedhin nga kryerja e shkeljes së si dhe të kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregulta.

KREU IV
VITI FINANCIAR -EKSPERTET
NENI 16
VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 Dhjetor, Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet më 31 dhjetor.

NENI 17
EKSPERTET

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakeve. Në përbushje të kësaj detyre eksperti kontabel i autorizuar për gatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara.

KREU 5
PRISHJA DHE RI-ORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 18
PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Shoqëria konsiderohet e shpërndarë kur:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqërisë
- b. Me vendimet e asamblese së Ortakeve
- c. Me hapjen e procedurave të falimentit
- d. Nëse nuk zhvillon aktivitet tregtar për 2 vjet dhe nuk është njoftuar përzullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit,
- e. Me vendim gjykatë.

NENI 19
RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblese së Ortakeve, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit mbi shoqëritë tregtare.

ART. 20
KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT



Ortakët dhe administratorët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, nuk mund të mbajnë pozicionin drejtues apo të jenë të punësuar në një shoqëri që ushtron aktivitet në të njëjtën fushë me të parën. Ndalimi i pikës 1 mund të anulohet në asamblenë e parë të përgjithshme me ³/₄ e votave në sipas dispozitave të nenëve 87 dhe 145 të ligjit për shoqëritë tregtare.

NENI 21
LEGJISLACIONI

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

NENI 22
MOSMARRVESHJET

Për mosmarrveshjet midis ortakëve të shoqërisë, ose shoqërisë me të tretet, gjykata kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u redaktua në 2 kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtte ligjore.

ORTAKET THEMELUES

Miranda Nela

